



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 1 shkurt 2016
Nr. ref.:RK883/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI100/15

Parashtrues

**Nurten Luboteni, Gazmend Luboteni, Suna Buçinca, Lulieta Hoxha,
Mytaher Luboteni, Valbon Luboteni, Veton Luboteni, Diellza Luboteni,
Rona Luboteni, Edi Luboteni dhe Bashkim Spahiu**

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të
Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje
që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0314, të 23
dhjetorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Nurten Luboteni, Gazmend Luboteni, Suna Buçinca, Lulieta Hoxha, Mytaher Luboteni, Valbon Luboteni, Veton Luboteni, Diellza Luboteni, Rona Luboteni, Edi Luboteni dhe Bashkim Spahiu (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), të përfaqësuar nga avokati z. Mas-har Pirana.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit AC-I-14-0314 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme), të 23 dhjetorit 2014.
3. Vendimi i kontestuar u ishte dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 21 janar 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jetë shkelur e drejta e parashtruesve për mbrojtje të pronës, siç garantohet me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 23 korrik 2015, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 9 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 11 shtator 2015, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 22 dhjetor 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 21 prill 2009, paraardhësit ligjor të parashtruesve të kërkesës kanë iniciuar në Gjykatën Komunale në Prizren procedurën gjyqësore për anulimin e kontratës së shitblerjes së pronës.
11. Procedurat gjyqësore u zhvilluan në instanca të ndryshme deri te Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme.
12. Në të vërtetë, më 23 dhjetor 2014, Kolegji i Apelit (Aktgjykimi AC-I-14-0314), refuzoi ankesën e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

13. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: *“u janë shkelur të drejtat elementare kushtetuese të tyre në mbrojtjen e të drejtave në pronë e në bazë të nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të drejtave të garantuara me nenin 1 të Protokollit numër 1. të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut”.*

Pranueshmëria e kërkesës

14. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

16. Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

...

(c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi; ose [...]”.

17. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Aktgjykimi i kontestuar u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 21 janar 2015. Parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatë më 23 korrik 2015. Pra, më shumë se 4 (katër) muaj kanë kaluar nga dita kur Aktgjykimi u ishte dorëzuar parashtruesve të kërkesës.

18. Gjykata konsideron se kërkesa është e paafatshme.

19. Prandaj, Gjykata konkludon se në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 22 dhjetor 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi